VENDIM
Nr. 504, datë 30.5.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS "KAPANONI 22", ME SIPËRFAQE 290.7 M^2 ME VENDNDODHJE NË KOMUNËN FARKË, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT TE MINISTRIA E BRENDSHME, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës "Kapanoni 22", me sipërfaqe 290.7 (dyqind e nëntëdhjetë pikë shtatë) m^2, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit te Ministria e Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për sistemimin e Stacionit të Policisë, Farkë, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi (pjesa e ngjyrosur).

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit, e miratuar me vendimin nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, dhe t'i shtohet listës së inventarit të pronave që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha